



DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE



**European Bank**  
for Reconstruction and Development

Ky material është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe përmban informacion mbi të drejtat dhe detyrimet tatimore për kategorinë:

### **Tregtarët Ambulantë**

Qendra e thirrjeve: 0800 00 02 (pa pagesë).

Orari: E Hënë - E Enjte ora 08:30 - 18:00; E Premte ora 08:30 - 16:00

 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)



**European Bank**  
for Reconstruction and Development



DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE

# **INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT**

## **Tregtarët Ambulantë**

## Tregtarët Ambulantë

### 1. Biznesi ushtrohet edhe si tregtar ambulant nëse:

- Ke mbushur moshën 16 vjeç;
- Je i vetëpunësuar, pa të drejtë punësimi të personave të tjerë dhe anëtarëve të familjes;
- Ushtron veprimtarinë me statusin e personit fizik, pa pasur një vend biznesi fiks; dhe
- Tregton në ambiente publike me leje të posaçme të lëshuar nga Bashkia.

### 2. Edhe pse je ambulant ke detyrim të regjistrohesh:

- Në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) që mbulon vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- Duke paraqitur dokumentat e kërkuara:
  - Kërkesë me shkrim;
  - Formular regjistrimi që e plotëson në sportelin e DRT;
  - Kartë Identiteti;
  - Leje nga Bashkia, që të lejon të tregtosh në vende publike të përcaktuara nga ajo;
- Dhe të marrësh Certifikatën e Regjistrimit (NIPT), që lëshohet nga DRT brenda 2 ditësh.

### 3. Menjëherë pas regjistrimit fillestar në DRT:

- Ke mundësinë të deklarosh veten tënde nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik, duke përdorur :
  - NIPT-in, si emër përdoruesi, dhe
  - “Tatimetemia12”, si fjalëkalim fillestar

**Kujdes:** Këtë deklaram mund ta bësh jo më vonë se 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklaratës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Në këtë rast llogaritja e detyrimit fillon që nga data e regjistrimit në DRT.

### 4. Si tregtar ambulant ke detyrime tatimore për:

- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vete, **4,246** lekë/ muaj:
  - 2,750** lekë/muaj për sigurime shoqërore;
  - 1,496** lekë/muaj për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

**Kujdes:** Deklarimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore kryhet online, nëpërmjet faqes elektronike të tatimeve, [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

- Tarifën për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi;
- Taksat e tjera bashkiake.

### 5. Paga e detyrimeve bëhet në afatet dhe mënyrat e caktuara:

Tabela 1 – Shuma, afatet dhe vendi i pagesës së Detyrimeve Tatimore

Lloji i detyrimit	Shuma (në lekë)	Afati i pagesës	Vendi i pagesës
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	12,738 lekë për 3-muaj	Çdo tre muaj, brenda datës 20 pas mbylljes së tremujorit (20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; dhe 20 Janar)	Bankë
Taksa e zënies së hapësirës publike	Tarifë mujore sipas vendimit të Këshillit Bashkiak (KB), për njësi të sipërfaqes dhe zonës	Çdo muaj, brenda datës së fundit të muajit ose afateve të caktuara nga KB	Bankë
Taksa të tjera	Tarifë vjetore sipas llojit të taksës	Sipas vendimit të KB	Bankë

### 6. Nëse vendos që të ndërpresësh veprimtarinë duhet të çregjistrohesh:

- Me një kërkesë në DRT-në ku je regjistruar;
- Mbasi ke paguar të gjitha detyrimet tatimore.